



Eksplozivi te ish-magazinat e grumbullimit në Mamurras, policia: Ishte futur në një bidon plastik



© 12:42 - 6 Korrik, 2023



Gjatë paradites së sotme një sasi lëndë eksplozivi u konstatua në ish-magazinat e grumbullimit në Mamurras.

Për fat të mirë ajo u gjet e paplasur, ndërsa godinat ishin në pronësi të shtetasit Spahi Jahja nga Laçi, i cili i kishte kthyer në biznes.

LEXO EDHE: VIDEO/ I vihet eksploziv ish-magazinave të grumbullimit në Mamurras, nisin hetimet

Policia njofton se lëndë eksplozive ishte futur në një bidon plastik, ndërsa pak më tutje është konstatuar edhe një kapsollë donatore me fitil zjarrpërcjellës, e paplasur.

“Blutë” po ashtu raportojnë se forcat xheniere bën të mundur heqjen dhe largimin e lëndës plasëse, ndërsa grupi hetimor vijon punën për zbardhjen e ngjarjes si edhe për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Njoftimi i policisë:

Kurbin/Informacion paraprak

Në lagjen “Drita”, në Mamurras, në pjesën e pasme të godinës së një biznesi privat në pronësi të shtetasit S. J., 57 vjeç, banues në Laç, është konstatuar një sasi e vogël lënde plasëse artizanale (amonit malor), e futur në një bidon plastik, si dhe në një distancë më tutje, është konstatuar edhe një kapsollë detonatore me fitil zjarrpërcjellës, e paplasur.

Nga shërbimet e specializuara xheniere, u bë heqja dhe largimi i lëndëve plasëse.

Grupi hetimor vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të këtij rasti, si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve..[r.t/abcnews.al](https://www.abcnews.al)

*Kryesore

Aktualitet

Eksplziv

Mamurras

Reagim I Policise

Të ngjashme

VIDEO/ I vihet eksploziv ish-magazinave të grumbullimit në Mamurras, nisin hetimet

Hidhet në erë me eksploziv bankomati në Shkup, detajet e para

Video/ Aksident në aksin Laç-Mamurras, plagosen tre të rinjtë



© 13:48 - 6 Korrik, 2023

Vrasja e efektivit të policisë Xhulio Prela, Prokuroria kërkon 20 vite...

© 13:46 - 6 Korrik, 2023

Newcastle nuk mjaftohet vetëm me Tonali, gati goditja e madhe për...

© 13:37 - 6 Korrik, 2023

Hakmarrje ndaj Helsinkit, Rusia dëbon nëntë diplomatë finlandezë

© 13:36 - 6 Korrik, 2023

VIDEO/ Hëngri 62 hot dog në 10 minuta, burri tregon se si u ndje më pas

© 13:32 - 6 Korrik, 2023

Tensionet në veri, Gjermania ndërpret bashkëpunimin me...

© 13:28 - 6 Korrik, 2023

FOTO/ Bella Hadid pozon për “Victoria’s Secret”, zbulon trupin perfekt

© 13:27 - 6 Korrik, 2023

“Ballkani i Hapur i ka bërë nder rajonit”, Kovačevski: Thirrje liderëve të marrin...

© 13:18 - 6 Korrik, 2023

Sipas psikologes së Harvardit, këto janë 5 frazat toksike që përdorin...

ABC NEWS AL
info@abcnews.al
+355 67 400 9040

Rreth nesh

Abcnews.al është website kryesor i lajmeve në Shqipëri. Pjesë e televizionit ABC, redaksia e Abcnews.al ka të shenjtë verifikimin e lajmit në mënyrë të pavarur nga gazetarët tanë para publikimit. Me një redaksi të riorganizuar, Abcnews.al mundëson një mbulim të plotë të zhvillimeve më të fundit nga vendi dhe bota, përmes një stafi të kualifikuar dhe profesional. Saktësia në informim mbështetet edhe me risitë më të fundit në lidhje me mediat online duke e bërë Abcnews.al një media avangardë në vend. NUIS/NIPT K01711004F

| "Cash" | Privacy | Kushtet e Përdorimit |

Harta e faqes

Aktualitet

Botë

English

Politikë

Ekonomi

Life

Rajon

Emisione

Plus

Sport

Moti

